

FOL

**PERFORMANCA
E AVOKATURËS
SHTETËRORE
GJATË VITIT 2021**



JANAR 2022

Titulli: Performanca e Avokaturës Shtetërore gjatë vitit 2021

Autor: Lëvizja FOL

Viti i botimit: Janar 2022

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542



FOL

Të drejtat e autorit © 2022. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.









*Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të programit MATRA të Ambasadës Holandeze në Kosovë.

PËRMBAJTJA

GJETJET KRYESORE.....	3
HYRJE.....	4
KORNIZA LIGJORE	5
STRUKTURA ORGANIZATIVE E AVOKATURËS SHTETËRORE.....	6
KAPACITETET E KUFIZUARA TË KËTIJ INSTITUCIONI.....	7
EFIKASITETI I PUNËS SË AVOKATURËS SHTETËRORE GJATË VITIT 2021	8
NUMRI DHE LLOJI I LËNDËVE TË KRIJUARA GJATË VITIT 2021 KU AVOKATURA SHTETËRORE PARAQITET SI PËRFAQËSUESE LIGJORE	8
NUMRI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË SJELLURA GJATË VITIT 2021.....	10
SHUMAT E FITUARA DHE TË HUMBURA NGA INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË LIDHJE ME PROCEDURAT GJYQËSORE.....	11
REKOMANDIME.....	13

GJETJET KRYESORE

Në bazë të të dhënave që i kemi siguruar në lidhje me punën e Avokaturës Shtetërore në Republikën e Kosovës, në vijim do të përshkruajmë disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti.

-  Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 janë krijuar gjithsej 3,417 lëndë të reja në rastet ku palë kanë qenë institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore, përkatësisht 57% më shumë se sa në vitin paraprak (2,180 lëndë në vitin 2020).
-  Numri më i madh i këtyre lëndëve të krijuara gjatë vitit 2021 ishin nga procedura kontestimore (1574 lëndë apo 46.06%), administrative (1382 lëndë apo 40.44%), përmbarimore (221 lëndë apo 6.47 %), jo-kontestimore (120 lëndë apo 3.51%) dhe nga lëndët e procedurës penale (120 lëndë apo 3.51%).
-  Gjatë kësaj periudhe një-vjeçare, në kontestet ku si palë e paditur apo paditëse kanë qenë institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore, Gjykatat e Republikës së Kosovës kishin sjellë gjithsej 1,584 aktgjykime.
-  Nga këto aktgjykime, Institucioni i Avokaturës Shtetërore i kishte fituar 681 raste, ndërsa 672 i kishte humbur. Gjatë kësaj periudhe ishin sjellë edhe 138 vendime nga procedurat e shpronësimit (vlera totale e të cilave ishte 22,253,219.69 €) dhe 83 vendime të përmbarimit (me vlerë prej 2,948,687.17 €).
-  Nga këto përfaqësime, institucionet e Republikës së Kosovës kishin fituar gjithsej 5,579,530.99 €. Ndërkaq shuma e paguar nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës palëve që kanë pasur sukses në kontestet gjyqësore në vitin 2021 ishte 2,139,988.49 €.
-  178 vendime të sjellura gjatë periudhës janar-tetor 2021 nga këto lëndë ishin në lidhje me kontestet e punës, e me theks të veçantë për shkarkimet e padrejta nga puna e të punësuarve në institucionet publike. Vlera e fituar e institucioneve shtetërore veçanërisht nga kontestet e punës ishte 120,300.11 €, ndërsa vlera e humbur ishte dyfish më shumë, përkatësisht 325,389.99.
-  Vetëm gjatë vitit 2021, Avokatura Shtetërore ka përfaqësuar Qeverinë e Republikës së Kosovës në gjithsej 5,310 seanca gjyqësore.
-  Aktualisht në Avokaturën Shtetërore, përveç Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, veprojnë vetëm 11 punëtorë, 9 prej të cilëve janë avokatë shtetëror, ndërsa 3 të tjerë zyrtarë të lartë ligjor. Pra barra e mbrojtjes së institucioneve shtetërore, përkatësisht ministrive, nga paditë që ushtrohen nga ana e personave fizik apo juridik u bie vetëm 9 avokatëve shtetërorë.

HYRJE

Përmbushja e qëllimeve programore dhe realizimi i detyrimeve të përcaktuara ligjore nga ana e institucioneve të ndryshme të Republikës së Kosovës përbën segmentin funksional të udhëheqjes sistematike institucionale. Detyrimet e tilla institucionale duhet përmbushur duke respektuar kornizën rigjide ligjore dhe kushtetuese. Pra, respektimi i plotë i Kushtetutës dhe ligjeve pozitive të vendit, nënkupton udhëheqje të bazuar në parime dhe vlera demokratike.

Mirëpo, gjatë ushtrimit të detyrave të fushëveprimtarisë, institucionet mund të përballen me konteste apo mosmarrëveshje me palë të treta, qofshin persona fizik apo juridik. Në këso rrethana në të cilat mund të gjendet çdo institucion, lind nevoja e kërkimit të mbrojtjes gjyqësore apo thënë ndryshe realizimi i të drejtave të pretenduara nëpërmjet rrugëve gjyqësore.

Në këtë botëkuptim, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është themeluar Avokatura Shtetërore si organ qendror i administratës, i cili paraqitet si mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm i përfaqësimit të pavarur ligjor të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës. Qëllimi i ekzistimit të këtij organi shtetëror përbëhet nga tri shtylla: përfaqësimi, këshillimi dhe mbrojtja e autoriteteve publike të Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh faktin se ky institucion është themeluar në vitin 2013, duhet thënë se institucioni i Avokaturës Shtetërore funksionalisht ende gjendet në pozitë të formimit dhe ndërtimit sistematik si organ i administratës shtetërore.

Ky raport mëton që të shtjelloj punën dhe funksionin e institucionit të Avokaturës Shtetërore, si dhe të shtjelloj efikasitetin e këtij institucioni në përfaqësimin e shtetit gjatë vitit 2021. Në këtë mënyrë do të mund të krijojmë një pasqyrë reale të punës së Avokaturës Shtetërore gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe njëkohësisht këto të gjetura do të shërbejnë si bazë për përpilimin e rekomandimeve për përmirësimin e punës së këtij institucioni.

Në pjesën e parë të këtij raporti është përmbledhur korniza ligjore mbi bazat e të cilit ky institucion e kryen funksionin dhe ngarkohet me përgjegjësi. Roli, funksioni dhe rëndësia e Avokaturës Shtetërore gjithashtu përfshihen në pjesën e parë të këtij raporti.

Me qëllim të krijimit të një pasqyre sa më reale të punës së Avokaturës Shtetërore, në pjesën tjetër të raportit, FOL ka analizuar epilogjet e rasteve gjyqësore në të cilat institucionet shtetërore kanë qenë palë (të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore) për vitin 2021, të dhëna këto të marra përmes përgjigjes në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, të drejtuar këtij institucioni.

Nga këto të dhëna, FOL ka krijuar një pasqyrë përmbledhëse në lidhje me numrin e rasteve të fituara/humbura kur janë përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, numrin dhe llojin e lëndëve të krijuara në vitin 2021, vlerën e shumave të fituara dhe të humbura nga institucionet shtetërore nga detyrimet e parapara në vendimet gjyqësore të sjella gjatë vitit 2021, si dhe vlerën e shpronësimeve dhe ato nga procedurat përbarimore. Ndërsa në fund, FOL ka dhënë disa rekomandime, të cilat do të kontribuonin në rritjen e performancës dhe efikasitetit të këtij institucioni.

KORNIZA LIGJORE

Obligimi ligjor i Avokaturës Shtetërore shtrihet në drejtim të mbrojtjes së autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në parimin e garancisë kushtetuese të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave. Përkrah të drejtës së qytetarëve për mbrojtje gjyqësore në realizimin e të drejtave të tyre përmes mjeteve juridike, ashtu edhe institucionet shtetërore gëzojnë mundësinë institucionale që për realizimin e të drejtave në procedura gjyqësore, të përfaqësohen në gjykatat e vendit apo përmes procedurave të arbitrazhit. Kësisoj, Avokatura Shtetërore si organ i administratës qendrore, përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës së Kosovës.

Për të garantuar drejtësinë administrative, në **Ligjin (nr. 06/L - 054) për Gjykatat**, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, është paraparë themelimi i Departamentit për Çështje Administrative[1], si departament kompetent për të vendosur në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe çështjeve të tjera të përcaktuara me ligj. Ky departament funksionon në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ka kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Një departament i tillë funksionon edhe në Gjykatën e Apelit si shkallë e dytë, ku shqyrtohen ankesat e gjykatës së shkallës së parë.

Në prill të vitit 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte miratuar **Ligjin (nr. 04/L-157) për Avokaturën Shtetërore**, qëllimi i të cilit është themelimi, organizimi dhe përcaktimi i kompetencave të Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, kushtet dhe procedura për emërimin dhe shkarkimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe të avokatëve shtetëror, mjetet për punë, autorizimet e tyre, të drejtat dhe detyrimet, si dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e këtij institucioni.[2] Me hyrjen në fuqi të këtij ligji është shfuqizuar ligji i mëparshëm i aplikueshëm për avokaturën publike.[3]

Avokatura Shtetërore përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës së Kosovës në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurën administrative.[4]

Me punën në institucionin e Avokaturës Shtetërore udhëheq dhe drejton Avokati i Përgjithshëm Shtetëror. Ky institucion gjithashtu ka edhe një numër të caktuar të avokatëve shtetëror, struktura organizative e të cilëve rregullohet me akt nënligjor, që e miraton Ministria e Drejtësisë.[5]

Në Kreun e III të Ligjit të Avokaturës Shtetërore është rregulluar detajisht çështja e procedurës dhe e kushteve të emërimit të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatëve të tjerë shtetëror. Sipas nenit 17 të këtij ligji, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror emërohen me konkurs të hapur publik nga Ministria e Drejtësisë, sipas procedurës së paraparë me dispozitat për emërimin për pozitën e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Përveç kushteve të përgjithshme (shtetësia e Republikës së Kosovës, provimi i jurisprudencës, të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale etj.), Ligji për Avokaturën Shtetërore parasheh se për t'u emëruar si Avokat i Përgjithshëm Shtetëror nevojiten edhe 10 vite përvojë pune në punët juridike në ndonjë institucion të drejtësisë, avokaturës apo në institucione tjera, ndërsa për avokatët shtetëror së paku edhe 5 vite përvojë pune në të njëjtat fusha.

[1] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat, neni 17.

[2] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, neni 1.

[3] Po aty, neni 32.

[4] Po aty, neni 8.

[5] Po aty, neni 13.

Sipas këtij ligji, puna e Avokaturës Shtetërore është publike dhe secili person mund të ketë qasje në informacionet e këtij institucioni, në pajtim me ligjin. Ndërkaq rregullat e procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve, përshtatshëmrisht zbatohen edhe për përjashtimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe për avokatët shtetëror.

Duhet të theksohet se në legjislaturën e shtatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishte propozuar një plotësim-ndryshim i Ligjit të Avokaturës Shtetërore, i cili për shkak të shpërndarjes së Kuvendit asokohe ishte kthyer në pikën zero. Sipas ish-Ministrit të Drejtësisë, Selim Selimit, ndër çështjet që parashihej të përfshihej në këtë ligj, ishte edhe obligimi për denoncimin e keqpërdorimeve. Sipas tij, në projektligjin e ri parashihej që çdo avokat i shtetit në momentin që sheh keqpërdorime do të ketë për obligim t'i denoncojë me kallëzime penale keqpërdorimet në fjalë tek Prokurori i Shtetit.[6]

Në lidhje me këtë projektligj, ish-Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, Sami Istrefi, kishte thënë se do të plotësohej vakumi institucional duke i dhënë mbështetje dhe status të merituar Avokaturës Shtetërore.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AVOKATURËS SHTETËRORE

Avokatura Shtetërore është organ i pavarur, i themeluar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me përgjegjësinë e mbrojtjes së interesave dhe të drejtave pronësore të Republikës së Kosovës dhe të organeve të tjera shtetërore të themeluara me ligj.

Bazuar në legjislationin në fuqi, Institucioni i Avokaturës Shtetërore udhëhiqet nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, i cili emërohet për një periudhë 3 vjeçare dhe mund të emërohet përsëri. [7]

Avokatura Shtetërore ka edhe një numër të caktuar të avokatëve shtetëror, të cilët sikurse Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, janë plotësisht të pavarur në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve të tyre. Avokatët shtetëror për punën e tyre i përgjigjen Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, ndërsa ky i fundit për punën e tij i përgjigjet Ministrit të Drejtësisë. Avokatët shtetëror nuk kanë ndonjë kufizim të mandatit.

Për kryerjen e punëve profesionale dhe administrativo-teknike, Avokatura Shtetërore ka edhe një numër të caktuar të nëpunësve civil. Avokatura Shtetërore gjithashtu mund të punësojë edhe një numër të caktuar të zyrtarëve profesional, të cilët iu ndihmojnë bartësve të funksioneve në kryerjen e punëve juridike. [8]

Avokati shtetëror nuk mund të ushtroj funksione të tjera publike ose private të cilat janë në kundërshtim me funksionet e tij të përcaktuara me Ligjin për Avokaturën Shtetërore. Po ashtu, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror si dhe cilido avokat tjetër shtetëror, nuk mund të përfaqësojnë autoritetet publike nëse kanë interes personal direkt ose indirekt në rastin që gjykohet. Pra, avokatët shtetëror do të përjashtohen nga përfaqësimi juridik para procedurave gjyqësore në rast se ka konflikt interesi. [9] Në kryerjen e punëve të përfaqësimit, Avokatura Shtetërore është e autorizuar që të ndërmarr të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr pala në procedurë, në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

[6] Për më tepër, shih: https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1%2C15%2C2347&fbclid=IéAR1nyKZPulvn1g6é9xv8H2XviS0YXqé_vxFt5447U_3Snc2PÉsSsDrqjxqk

[7] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, neni 17.

[8] Po aty, neni 24.

KAPACITETET E KUFIZUARA TË KËTIJ INSTITUCIONI

Sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, numri i të punësuarve në Avokaturën Shtetërore është 11 [10], 9 prej të cilëve janë avokatë shtetëror, ndërsa 3 të tjerë zyrtarë të lartë ligjor.

Përveç Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, Arsim Zuka, në këtë institucion si avokat shtetërorë shërbejnë edhe Ilire Aydogan, Nexhmije Karaqi, Naime Abazi, Muharrem Kurtaj, Bedri Krasniqi, Fitore Gajtani, Shefqet Hasimi dhe Naim Krasniqi. [11]

Pra janë vetëm 9 avokatë shtetërorë që u bie barra e mbrojtjes së institucioneve shtetërore, përkatësisht ministrive, nga paditë që ushtrohen nga ana e personave fizik apo juridik. Këta 9 avokatë përballen me përfaqësimin e shtetit në mijëra padi për lloje të ndryshme të kontesteve, që ushtrohen nga këto biznese e individ ndaj institucioneve (apo anasjelltas).

Kjo tregon për mungesën e theksuar të kapaciteteve njerëzore dhe ngarkesën e madhe me të cilin ky institucion po përballlet ndër vite, prandaj rritja e numrit të avokatëve shtetëror paraqitet si nevojë imanente për mbrojtjen e duhur të buxhetit të shtetit.

Sipas raportit të punës së këtij institucioni për vitin 2020 [12], gjatë këtij viti ishin pranuar gjithsej 2.170 raste të reja, ndërsa sipas përgjigjes në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike të siguruar nga FOL, gjatë vitit 2021 janë krijuar 3,417 lëndë të reja, apo 57 % më shumë se në vitin paraprak.

Nëse numri i lëndëve të pranuar në vitin 2021 pjesëtohet me numrin e avokatëve shtetërorë që punojnë aktualisht me këto lëndë, i bie që një avokat të ketë 379 lëndë brenda një viti.

Gjithashtu, duhet të theksohet se Avokatura Shtetërore nuk disponon me ueb-faqe autonome të saj. Të gjitha informatat elektronike në të cilat publiku mund të ketë qasje, janë të dhënat e paraqitura për detyrat dhe përgjegjësitë e Avokaturës Shtetërore në kuadër të ueb-faqes së Ministrisë së Drejtësisë. Pra, megjithëse ky institucion është funksional që nga vitit 2013, në këtë ueb-faqe nuk ka të publikuar të dhëna të tjera për punën e Avokaturës Shtetërore, apo ndonjë raport tjetër vjetor, përveç atij të vitit 2020 dhe aktgjyqimeve të sjella për të njëjtin vit.

[9] Po aty, neni 14 dhe 15.

[10] Rregullorja nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, neni 28.

[11] Për më tepër, shih: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/3A26F597-408E-4F4F-9F6E-FBEACD27FA0E.pdf>

[12] Po aty.

EFIKASITETI I PUNËS SË AVOKATURËS SHTETERORE GJATE VITIT 2021

Institucioni i Avokaturës Shtetërore, si organ i administratës qendrore, paraqitet si një mekanizëm shtetëror i mbrojtjes dhe ruajtjes së interesit shtetëror. Përmes angazhimit dhe veprimtarisë së avokatëve shtetëror arrihet përmbushja e objektivave institucionale dhe mbrojtja ligjore e tyre. Institucionet shtetërore shpeshherë kanë nevojë për mbrojtje dhe ekspertizë juridike dhe përfaqësimi i tyre në procedura gjyqësore, apo këshillimi juridik, është pjesë e pashmangshme e kryerjes së obligimeve ligjore. Prandaj, Avokatura Shtetërore paraqitet si institucion i rëndësishëm i këshillimit, mbrojtjes dhe përfaqësimit juridik të tyre.

Efikasiteti i punës së Avokaturës Shtetërore drejtpërdrejt ndikon në performancën e institucioneve shtetërore, të cilat përfaqësohen nga avokatët shtetëror. Ballafaqimi i avokatëve shtetëror me secilën lëndë ose rast të mbrojtjes apo përfaqësimit, mes rreshtash nuk nënkuptohet vetëm si angazhim dhe kryerje e punës së tyre ditore, por edhe si detyrë mjaft serioze e mbrojtjes së të drejtave të institucioneve apo autoriteteve publike të Republikës së Kosovës.

Angazhimi i institucionit kompetent të administratës qendrore, pra i Ministrisë së Drejtësisë, në ngritjen dhe zhvillimin e institucionit të Avokaturës Shtetërore, paraqet një interes vital shtetëror i cili e kapërcen nevojën e kryerjes së punës burokratike. Kësisoj, vetëm përmes punës dhe motivit personal të avokatëve shtetëror, si dhe angazhimit të institucioneve kompetente në ngritjen dhe zhvillimin e këtij mekanizmi, do të mund të arrihet një stad i punës së qëndrueshme dhe efikase në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Një prej problemeve kryesore me të cilat vazhdon të përballlet Avokatura Shtetërore në Republikën e Kosovës shihet të jetë mungesa e burimeve njerëzore. Shtimi i resurseve njerëzore, e veçanërisht rritja e numrit të avokatëve shtetëror, pashmangshëm do të ndikonte në rritjen e performancës dhe efikasitetit të këtij institucioni.


NUMRI DHE LLOJI I LËNDËVE TË KRIJUARA GJATË VITIT 2021 KU AVOKATURA SHTETËRORE PARAQITET SI PËRFAQËSUESE LIGJORE

Në përputhje me të dhënat e dërguara nga Ministria e Drejtësisë përmes përgjigjjes në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Avokatura Shtetërore gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2021 ka pranuar gjithsej 3,417 lëndë të reja, ku përfshihen lëndë nga procedura kontestimore, jo-kontestimore, përmbartimore, administrative dhe penale.

Ky numër i lëndëve të krijuara ishte rritur dukshëm në raport me vitin e kaluar (vitin 2020), ku ishin krijuar gjithsej 2,180 lëndë. Pra gjatë vitit 2021 kishte pasur shtim të lëndëve për 56.7% më shumë se në vitin e kaluar. [13]

[13] Për më tepër, shih: <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2021/05/EFIKASITETI-I-AVOKATUR%C3%8BS-SHTET%C3%8BRORE.pdf>

Numri i lëndëve të krijuara gjatë vitit 2020 dhe 2021 është paraqitur në formë grafike në tabelën e mëposhtme.




Grafikoni 1.

Numri i lëndëve të pranuar gjatë vitit 2020 dhe 2021, ku palë paditëse ose e paditur kanë qenë institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore.

Numri më i madh i lëndëve të krijuara gjatë vitit 2021 ishin nga procedura kontestimore (1,574 lëndë), administrative (1,382 lëndë), përmbare (221 lëndë) dhe në fund nga lëndët e procedurës jo-kontestimore (120 lëndë) dhe nga ato të procedurës penale (120 lëndë).

Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë grafike janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin dhe llojin e lëndëve të krijuara gjatë vitit 2021, që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore.



Grafikoni 2.


Numri dhe lloji i lëndëve të pranuar gjatë vitit 2021, ku palë paditëse ose e paditur ishin institucionet shtetërore.

NUMRI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË SJELLURA GJATË VITIT 2021

Bazuar në përgjigjen e Avokaturës Shtetërore, të siguruar nga FOL përmes Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike, gjatë periudhës janar -dhjetor 2021 nga Gjykatat e Republikës së Kosovës janë sjellë gjithsej 1,584 vendime në lidhje me këto lëndë.

Sipas të dhënave të pranuar, institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore gjatë vitit 2021 i kanë fituar 681 lëndë, ndërsa 672 i kanë humbur (pra janë sjellë vendime në favor të personave fizik apo juridik që i kanë paditur).

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e kontesteve të fituara dhe të humbura nga institucionet shtetërore gjatë vitit 2021.



Grafikoni 3.

Numri i aktgjykimeve të fituara dhe të humbura të sjella në vitin 2021 në lidhje me rastet ku palë kanë qenë institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore.

Këto konteste në përgjithësi kishin të bënin me anulime të vendimeve, vërtetime të së drejtës së pronësisë, kompensime të dëmeve, kthimin e borxheve, kompensime të pagave, pasurim të pa bazë, ndërprerje të marrëdhënieve të punës nga institucionet publike, paga jubilarë etj..


Duhet të theksohet se 178 vendime të sjellura gjatë periudhës janar-tetor 2021 ku palë të paditura ishin institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore, ishin në lidhje me kontestet e punës, e me theks të veçantë për shkarkimet e padrejta nga puna në institucionet publike.

Vlera e fituar e institucioneve shtetërore veçanërisht nga kontestet e punës ishte 120,300.11 €, ndërsa vlera e humbur ishte dyfish më shumë, përkatësisht 325,389.99 €.

SHUMAT E FITUARA DHE TË HUMBURA NGA INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË LIDHJE ME PROCEDURAT GJYQËSORE

Nga vendimet e sjella në vitin 2021, ndërmjet detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore të Gjykatave të Republikës së Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës kanë fituar gjithsej 5,579,530.99 €. Ndërkaq shuma e paguar nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës palëve që kanë pasur sukses në kontestet gjyqësore në vitin 2021 ishte 2,139,988.49 €.

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur të dhënat në lidhje me vlerat e fituara dhe të humbura nga institucionet shtetërore gjatë vitit 2021.




Grafikoni 4.
Vlera e fituar dhe e humbur nga ana e institucioneve shtetërore (të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore) në vendimet e sjella gjatë vitit 2021.

Në raport me vitin 2020, ku vlera e fituar ishte afër 13 milion euro (saktësisht 12,849,600.80 €), nënkupton se kjo vlerë gjatë vitit 2021 kishte pësuar rënie për 56%.

Shteti gjithashtu gjatë kësaj periudhe kishte dhënë edhe mbi 22 milion euro (saktësisht **22,253,219.69 €**) në emër të procedurave të shpronësimeve dhe afër 3 milion euro në procedura të përmbarimit (saktësisht **2,948,687.17 €**). [14]

[14] Për më tepër, shih: <http://levizjafol.org/ep-content/uploads/2021/05/EFIKASITETI-I-AVOKATUR%C3%8BS-SHTET%C3%8BRORE.pdf>

Vlera e shpenzuar e shtetit në vitin 2021 për procedurat e shpronësimit dhe të përmbarimit është paraqitur në formë grafike në tabelën e mëposhtme.



Grafikoni 5.

Vlera e procedurave të shpronësimit dhe të procedurave të përmbarimit në vendimet e sjellura gjatë vitit 2021.

Krahas vlerës së lartë monetare të shpronësimeve, çështja e efikasitetit të Avokaturës Shtetërore në përfaqësimin me sukses të lëndëve të shpronësimit para Gjykatave të Republikës së Kosovës përben kategori relative, duke marrë parasysh se vëllimi i lëndëve të tilla varet nga shpronësimet e planifikuara apo të kryera gjatë vitit përkatës, apo lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake.

REKOMANDIME

Duke bërë ndërlidhjen në mes të gjetjeve të këtij raporti dhe intencës për ngritje të efikasitetit të punës së Avokaturës Shtetërore, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- Çështja e rritjes së numrit të të punësuarve në Institucionin e Avokaturës Shtetërore, duke përfshirë rritjen e numrit të avokatëve shtetëror dhe të stafit tjetër profesional, të merret me prioritet.
- Të rritet transparenca e Avokaturës Shtetërore në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, duke i paraqitur dhe shpërfaqur të gjitha informatat dhe dokumentet e karakterit publik, duke përfshirë edhe raportin mbi shfrytëzimin e buxhetit shtetëror, dokumentet strategjike, informatat nga prokurimet publike, raportet vjetore, të dhënat në lidhje me të punësuarit, raportet mbi punën e avokatëve shtetëror, si dhe të dhëna të tjera të domosdoshme për informimin e publikut.
- Të nxirret akti nënligjor për organizimin e brendshëm të Avokaturës Shtetërore, i paraparë me legjislacionin në fuqi.
- Të organizohen seminare, punëtori dhe takime të shpeshta koordinuese me përfaqësuesit ligjor të komunave, në mënyrë që të adresohen dhe shkëmbehen sfidat, përvojat dhe nevojat e tyre.
- Të stimulohet trajnimi dhe specializimi i avokatëve shtetëror në lëmi të ndryshme nga fusha e drejtësisë, duke organizuar ligjërata dhe trajnime me profesorë universitar, ekspertë të fushave, gjyqtarë dhe prokurorë.

BURIMET

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L – 054 për Gjykatat.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore.
3. Rregullorja nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
4. https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1%2C15%2C2347&fbclid=IëAR1nyKZPulvn1g6ë9xv8H2XvIS0YXqë_vxFt5447U_3Snc2PËsSsDrqjxqk
5. <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/2EF405F5-1FCF-47C5-91A4-F89A0E007F10.pdf>
6. <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/3A26F597-408E-4F4F-9F6E-FBEACD27FA0E.pdf> .
7. <http://levizjafol.org/ëp-content/uploads/2021/05/EFIKASITETI-I-AVOKATUR%C3%8BS-SHTET%C3%8BRORE.pdf>